

VENDIM
Nr.877, datë 14.12.2011

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.1153, DATË 13.8.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE PUBLIKE
TË SHTETIT NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË KOMUNËS RRASHBULL” DHE
PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.314, DATË 12.3.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PYJEVE DHE
KULLOTAVE QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KOMUNËS RRASHBULL, TË
QARKUT DURRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1153, datë 13.8.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet edhe lista e inventarit të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Rrashbull, të qarkut të Durrësit, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 1 (një).

2. Në vendimin nr.314, datë 12.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet edhe lista e inventarit përfundimtar të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të komunës Rrashbull, të qarkut të Durrësit, me 1 (një) fletë, e cila përfundon me numrin rendor 2 (dy).

3. Listat me shitesat për inventarin dhe transferimin dhe lidhja me numrin 1 (një), i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Rrashbull, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha